

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-204/2014**

**Prishtinë,  
8 shtator 2016**

Në çështjen juridike të:

**S.Sh.**

Fshati Novosellë  
Prizren

***Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë***

kundër.

**P.P.**

Bokokotorska 10,  
34000 Kragujevac  
Serbi

***Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi e kërkesës***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA07754), të datës 13 Mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 shtator 2016, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.Sh. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/2014 të datës 13 Mars 2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA07754.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/2014 i datës 13 Mars 2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin 07754

### Përmbledhja faktike dhe procedurale:

1. Më 29 Dhjetor 2006 P.P. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku ka kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore dhe riposëdimitin e një ngastre nr. 4543, në sipërfaqe prej 5 ar 64 m<sup>2</sup>, e evidentuar në Fletën Poseduese nr. 14, Zona Kadastrale Verbiqan/Verbiçane, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ai ka deklaruar se prona shfrytëzohet nga persona të panjohur pa asnjë të dejtë ligjore.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kerkesës në mes tjerash ka paraqitur edhe këto dokumente:
  - Fleta poseduese Nr. 14 datë 10 Nëntor 2006 lëshuar nga Enti për Kadstër e dhe Palujtshmeri i Prizrenit që dëshmon se ngastra kadastrale 543 me sipërfaqe prej prej 5 ar 64 m<sup>2</sup> është e evidentuar në emër të Palës Përgjegjëse;
  - Letërnjoftim lëshuar nga Autoritetet e Serbisë në Kragujevac me 1 Tetor 1997
  - Më vonë zyrtarët e AKP-së kanë gjetur edhe Çertifikata e pronësisë P-71813007-00543-0 që dëshmonë se prona është e regjistruar në zyrën kadastrale përkatëse në emër të P.P. ;
3. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 20 Gusht 2010, mund shihet se AKP-ja ka verifikuar pozitivisht dokumentet e paraqitura nga ana e paraqitësit të kërkesës.
4. Njoftimi i kërkesës është bërë me 29 gusht 2007. Prona është gjetur si kullosë dhe e uzurpuar nga S.Sh. (në tekstin e mëtejme: Ankuesi), i cili ishte i pranishëm në pronë. Me 30 Mars 2010, bazuar në koordinatat GPS, AKP-ja kishte konfirmuar së njoftimi i pronës ishte i saktë.

5. Me 29 Gusht 2007 Ankuesi ka pranuar Njoftimin e Kërkesës dhe ka nënshkruar deklaratën në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë duke pohuar se pretendon të drejta ligjore mbi pronën e kërkuar. Ai nuk ka paraqitur në kohën e paraparë asnjë dokument në mbështetje të pohimeve të tij.
6. Më 13 Mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/227/2014, Pala përgjegjëse në ankesë kishte dëshmuar se është pronar 1/1 i ngastrës 543, dhe i kthehej posedimi dhe urdheroheshin personat tjerë që brenda 30 ditës ta lirojnë pronën nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
7. Në paragrafet 16-18 të vendimit Komisioni arsyeton se pala përgjegjëse-paraqitësi i kërkesësë ka dëshmuar se është pronar mbi bazën e dokumentave të verifikuar pozitivisht nga AKP-ja. Komisioni ka konstatuar Ankuesi edhe pse ka pretenduar të drejta ligjore mbi pronën mbi bazën e një transakcioni joformal në vitin 1985 ai nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme dhe kërkesa duhej aprovuar.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 9 Qershor 2014. Më 8 Korrik 2014 pala përgjegjëse në kërkesë (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) e ka kundërshtuar vendimin Komisionit

**Pretendimet e palëve:**

*Pala ankuese/Pala përgjegjëse në ankesë:*

9. Pala ankuese në ankesën e tij të ushtruar pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor, rrespektivisht moszbatim të ligjit procedural dhe se mbështetet në vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai pretendon se Komisioni nuk e ka marrë në shqyrtim pretendimin e tij se prona ishte blerë në vitin 1985 bashkë me disa ngastra tjera.
10. Në procedurën para AKP/KKPK-ës ai nuk kishte parashtruar asnjë provë në mbështetje të pohimeve por në ankesë pala ankuese pretendon se kanë hyrë një transakcion me pronarin dhe bashkë me disa ngastra tjera prona është blerë në vitin 1985 për shumën e përgjithëshme prej 100 Milion Dinarë dhe se transakcioni joformal është bërë në prezencën e dy deshmitarëve

11. Në mbështetje të ankesës ai ka parashtruar në Gjykatën Supreme një deklaratë të vten të shkruar, të pavërtetuar që pohn se prona është blerë në praninë e deshmitareve A.Xh. dhe personi me emrin Raim mbiemrin e të cilit nuk e kujton..

*Pala përgjegjëse në ankesë/ Paraqitësi i kërkesës:*

12. Palës përgjegjëse ankesa i është dorëzuar me datë 29 Janar 2015 por ai ka zgjedhur të mos përgjigjet në pretendimet e ankesës.

### **Arsyetimi ligjor**

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*këtej e tutje Ligji nr. 03/L-079*) dhe është e pranueshme.
14. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së në mesin e dokumenteve të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë, ka verifikuar pozitivisht Fletën Poseduese dhe Certifikatën e pronësisë
15. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i ankimuar gjithashtu bazohet edhe në faktin se pala ankuese nuk kishte paraqitur ndonje kontratë shitëblerjeje e cila do të shërbente si bazë mbështetëse e pretendimit e tij - se pala ankuese kishte blerë pronën e kërkuar. Në të vërtetë Gjykata konstaton gjithashtu se pala ankuese në shitëblerjen eventuale të pronës së kërkuar nuk ka vepruar në përputshmëri me kriteret e përcaktuara në dispozitate ligjit i cili si i aplikuar në kohën e arritjes së shitëblerjes së pretenduar, kërkonte si kusht ekzistimin e kontratës së shitëblerjes së paluajtshmërisë në formën e shkruar dhe me nënshkrimet e palëve të vërtetuara nga ana e gjykatës.
16. Për Gjykatën është i drejtë dhe ligjshëm konstatimi në vendimin e KKPK-ës, pala përgjegjëse-paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se është pronar mbi bazën e dokumentave kurse pala ankuese nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme dhe për keto arsye kërkesa duhej aprovuar. Prandaj, nga kjo Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet ankimore të palës ankuese janë pabaza dhe të papranueshme për sa i takon të drejtës pronësore në pronën e kërkuar.

17. Me këtë rrjedhimisht pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë pronësore të tij në pronën e kërkuar, siç edhe nuk ka arritur edhe të atakoj sukseshëm konstatimin e KKPK-ës të dhënë në vendimin e se pala përgjegjëse është pronare e pronës së kërkuar.
18. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja vendimin e saj të drejtë dhe valid e ka mbështetur në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Prandaj, Gjykata Supreme përfundon se ankesa është e pabazuar.
19. Duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, në pajtim me nenin 13.3 nën pikën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

**Beshir Islami, Gjyqtar Kryesues**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it.**

**Sandra Gutaityde, Referente e EULEX-it**